



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURRENCËS-
-KABINETI-

Njoftim për Shtyp

Gjykata e Shkallës së Parë lë në fuqi vendimin e Komisionit të Konkurrencës për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjeve të prodhimit të betonit

Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, pasi shqyrtoi çështjen civile me palë paditëse “Shkodra Beton”, për pavlefshmërinë e vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 66, datë 18.12.2007 “Për vendosje gjobe për shkelje të lehtë”, vendosi rrëzimin e kërkesë padisë si të pabazuar në ligj dhe në prova, duke lënë në fuqi vendimin e Komisionit të Konkurrencës.

Me këtë vendim¹, Komisioni i Konkurrencës ka vendosur gjobë për 9 ndërmarrje prodhuese të betonit në qarkun e Tiranës për shkak se nuk kanë dhënë informacionin e kërkuar nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës.

¹ Per me shume shih: <http://www.caa.gov.al/file/lajme/gjoba.pdf>